



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.126**

**17 shtator**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.61, datë 16.9.2010	Për rrëzimin e dekretit nr.6664, datë 13.8.2007 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”.....	6789
Dekret nr.6666 datë 31.8.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	6789
Dekret nr.6667 datë 31.8.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	6790
Dekret nr.6668 datë 6.9.2010	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.....	6790
Vendim i KM nr.672, datë 13.8.2010	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.....	6791
Vendim i KM nr.673, datë 13.8.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për pagesën e komisionerëve në zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor, për disa bashki e komuna, më 15 nëntor 2009.....	6794
Vendim i KM nr.674, datë 13.6.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1184, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore qendrore”, të ndryshuar.....	6794

Vendim i KM nr.676, datë 13.8.2010	Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e personelit dhe të personave të kontaktit për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore, si dhe të detyrave e përgjegjësive të tyre.....	6795
Vendim i KM nr.677, datë 13.8.2010	Për shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, me koncesion”, të ndryshuar.....	6798
Vendim i ERE nr.53, datë 19.8.2010	Për licencimin e shoqërisë “Dishnica Energji” sh.p.k. ....	6798
Vendim i ERE nr.54, datë 25.8.2010	Për licencimin e shoqërisë “Elektro Lubonja” sh.p.k. ....	6799
Vendim i ERE nr.55, datë 25.8.2010	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “E-Vento Srl Albania” sh.p.k. ....	6800
Vendim i ERE nr.56, datë 25.8.2010	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Hera” sh.p.k. ....	6800
Kërkesë e MASH nr.5285, datë 17.8.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare publike, Lagja e Re, Kukës.....	6801
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Leonard Sema.....	6801

**VENDIM**  
**Nr.61, datë 16.9.2010**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR.6664, DATË 13.8.2007 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**  
**“PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR.10 308,**  
**DATË 22.7.2010 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235,**  
**DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr.6664, datë 13.8.2010 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET**  
**Nr.6666, datë 31.8.2010**

**PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                    |   |
|------------------------------------|---|
| 1. Ada Petrit Gjergjova            | 18. Helga Sokrat Theodhori                    |
| 2. Afërdita Mahmut Peterci (Hasa)  | 19. Holger Gezim Sulaj                        |
| 3. Alfreda Azem Wegerer (Braho)    | 20. Holta Jovan Grabovari-Gellert (Grabovari) |
| 4. Alketa Refat Eisendraut (Shehu) | 21. Iris Mesut Peterci                        |
| 5. Alkit Fatos Beqiraj             | 22. Joanna Arben Agimgostivari                |
| 6. Anjeza Alfred Radini (Shiroka)  | 23. Lejdja Albert Bejko                       |
| 7. Arben Ibrahim Agimgostivari     | 24. Mirjeta Çelnik Bickel (Taçi)              |
| 8. Astrit Imer Kraja               | 25. Ornela Nikollaq Lena                      |
| 9. Brunilda Osman Linning (Noka)   | 26. Patris Carol Adrian Alija                 |
| 10. Denisa Ferid Walloch (Shkreli) | 27. Sabine Gezim Sulaj                        |
| 11. Domenika Pal Bäumer (Dodaj)    | 28. Saimir Petrit Kasemi                      |
| 12. Edlira Ali Bundo               | 29. Shpresa Qazim Balk (Seseri)               |
| 13. Edmond Kristaq Beçi            | 30. Simo Petraq Kristidhi                     |
| 14. Entela Arif Topalli            | 31. Uendi Laert Eisendraut                    |

15. Farije Man Schwarz (Kafkani)  
16. Fatbardha Hasan Gurmani (Hoxha)  
17. Gëzim Azis Sulaj

32. Valdete Myzafer Luli  
33. Xheni Kujtim Aga  
34. Zihni Fadil Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6667, datë 31.8.2010**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Agim Musa Cana
2. Migjen Xhevat Basha
3. Shaindere Gani Cana (Vula)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6668, datë 6.9.2010**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 10, paragrafi 1, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zhvillohen ditën e diel, më datë 8 maj 2011.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.672, datë 13.8.2010**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË, NË  
FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE  
KOMUNIKIMIT (ICT)**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, më poshtë të cituara si “Palët”,

*në konsideratë* të zhvillimit të marrëdhënieve të mira ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë, e forcuar nëpërmjet vizitave të nivelit të lartë;

*në konsideratë* të interesit të përbashkët në promovimin e lidhjeve më të ngushta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

*në konsideratë* të palëve si pjesëmarrëse në ofrimin e teknologjisë dhe shërbimeve në sektorin e teknologjisë së informacionit, me qëllim ngritjen e një partneriteti në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

*në njohje* të nevojës për të promovuar lidhje të forta në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ndërmjet palëve, me qëllim përmirësimin e aftësive dhe mundësive nga të dyja palët;

*në njohje* të potencialit për tregti intensive ndërmjet dy vendeve, duke përfshirë sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

*duke pasur* interes të përbashkët në rritjen e investimeve, ndërmarrjeve të përbashkëta, iniciativave të përbashkëta dhe tregjeve në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; dhe

*duke pasur* parasysh implementimin e një programi bashkëpunimi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, me qëllim nxitjen e partneritetit në biznes ndërmjet palëve,

kanë rënë dakord për një memorandum mirëkuptimi, si vijon:

Neni 1  
**Objektivat e bashkëpunimit**

1. Objektivi i këtij memorandum mirëkuptimi (referuar më poshtë si MOU) është vendosja e marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet palëve, me qëllim koordinimin e përpjekjeve, si dhe burimeve teknike, financiare dhe njerëzore me objektiv kryesor zhvillimin e bashkëpunimit teknologjik dhe aktiviteteve inovative, si dhe asistencës, konsultimit dhe shërbimeve për trajnimin teknik që adresojnë formimin e burimeve njerëzore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Neni 2  
**Fushat e bashkëpunimit**

1. Fushat kryesore të bashkëpunimit ndërmjet palëve, jo të kufizuara nga sa më poshtë, janë:
  - a) Shkëmbimi i të dhënave në lidhje me rregulloret, standardizimet dhe konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe mjeteve teknike dhe teknologjive të reja.
  - b) Stimulimin e investimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në të dyja vendet.
  - c) Ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, bazuar në projekte të përbashkëta, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në të dyja vendet ose në një vend të tretë, nën kushte bashkëpunimi të pranuar bashkërisht.
  - d) Mbështetje për kompanitë e interesuara të të dyja vendeve, në aktivitetet e përbashkëta.
  - e) Trajnim në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
  - f) Zhvillim të burimeve njerëzore për edukimin mbi teknologjinë e informacionit dhe edukimin e bazuar mbi teknologjinë e informacionit.
  - g) Organizimi dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në seminare, konferenca, forume të përbashkëta dhe aktivitete e panaire ndërkombëtare, të organizuara nga të dyja vendet.
  - h) Identifikimi dhe informimi mbi nevojat për shkëmbimin e të dhënave për shërbimet elektronike si: shërbimet elektronike, vizat elektronike, tregtia elektronike dhe sigurinë elektronike.
  - i) Mbështetje e përbashkët në organizatat ndërkombëtare, kur përputhen interesat kombëtare të të dy vendeve.
2. Aktivitetet specifike me interes të përbashkët do të bëhen në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe do të rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve më specifike ose kontratave. Në këto marrëveshje/kontrata do të specifikohen çështje të veçanta në lidhje me shpenzimet apo investimet, konfidencialitetin, pronësinë intelektuale, si dhe detaje të tjera të cilat tregojnë qartë origjinën dhe përdorimin e burimeve dhe përfitimeve të palëve të përfshira.

Gjuha angleze do të jetë gjuha e punës në aktivitetet e organeve kompetente.

Neni 3  
**Financimi dhe burimet**

1. Zhvillimi i aktiviteteve bashkëpunuese sipas këtij Memorandum do të jenë në varësi të disponueshmërisë së burimeve dhe financimeve nga Palët.
2. Kostot e aktiviteteve të përbashkëta do të ndahen në një mënyrë të përcaktuar bashkërisht nga të dyja palët.

Neni 4  
**Implementimi i Memorandumit të Mirëkuptimit**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të implementohet nga një Komitet i Përbashkët i përbërë nga përfaqësues të të dyja palëve, struktura e të cilit do të vendoset në një kohë të mëvonshme. Ky Komitet do të krijohet brenda një periudhe 1-mujore nga hyrja në fuqi e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

2. Komiteti do të jetë përgjegjës për përcaktimin e metodologjive, mekanizmave dhe procedurave për zhvillimin e aktiviteteve të parashtruara nga ky Memorandum, duke përfshirë fizibilitetin dhe kërkesat financiare. Komiteti do të përpiqet të mbledhet të paktën 1-herë në vit në Shqipëri ose në Rumani, ashtu si është rënë dakord nga palët.

#### Neni 5

#### **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

Të drejtat e pronësisë intelektuale që rrjedhin nga projektet e bazuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi do të përcaktohen qartësisht dhe do të bihet dakord, nëpërmjet dokumenteve shtesë, të nënshkruara në datën e fillimit të çdo projekti të veçantë.

#### Neni 6

#### **Konfidencialiteti i informacionit**

Asnjëra nga palët nuk do të zbulojë ose shpërndajë informacion konfidencial, që i ofrohet nga pala tjetër, gjatë zhvillimit të aktiviteteve bashkëpunuese sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, një pale të tretë, përveç kur dhe në masën e autorizuar me shkrim nga pala tjetër ose kur kërkohet nga dispozitat ligjore.

#### Neni 7

#### **Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit ndërmjet palëve, nëpërmjet rrugëve diplomatike, mbi përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore në lidhje me hyrjen në fuqi të tij dhe është i vlefshëm për katër (4) vjet. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të shtyhet për periudha të tjera dy 2-vjeçare, përveç kur njëra nga palët e përfundon atë.

2. Secila palë mund ta përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi me njoftim me shkrim për palën tjetër në rrugë diplomatike. Në këtë rast, përfundimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi tre (3) muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër.

#### Neni 8

#### **Amendimet**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të amendohet me miratim të përbashkët me shkrim nga të dyja palët.

2. Amendimet e këtij Memorandum Mirëkuptimi do të hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtat procedura të parashikuara nga neni 7, paragrafi i parë.

#### Neni 9

#### **Dispozitat përfundimtare**

Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare për secilën palë. Zbatimi i këtij Memorandumi nuk cenon detyrimet e Rumanisë si shtet anëtar i Bashkimit Europian. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të referohet dhe interpretohet në mënyrë të tillë që të mos anulojë apo prekë detyrimet që rrjedhin nga ndonjë marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Komunitetit Europian, Komunitetit Europian dhe vendet anëtare në njërin anë, dhe Republikës së Shqipërisë në anën tjetër.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e palëve të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Nënshkruar në Tiranë, më 8 qershor 2010 në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, rumune dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rast mospërputhjes në interpretim teksti i gjuhës angleze ka përparësi.

**VENDIM**  
**Nr.673, datë 13.8.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR PAGESËN E KOMISIONERËVE NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR PUSHTETIN VENDOR, PËR DISA BASHKI E KOMUNA, MË 15 NËNTOR 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 3 900 000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekësh, për pagesën e komisionerëve në zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor, për disa bashki e komuna, të zhvilluara më 15 nëntor 2009, i ndarë përkatësisht:

- 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë për paga;

- 500 000 (pesëqind mijë) lekë për mallra e shërbime.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.674, datë 13.6.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1184, DATË 20.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT E TË EMËRIMIT, TË AFATEVE TË KALIMIT NGA NJË NIVEL MË I ULËT NË NJË NIVEL MË TË LARTË KARRIERE DHE PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pikat 2 e 3, e 22 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 15.3 e vendimit nr.1184, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15.3 Për shqyrtimin e rasteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ngre komitetin disiplinor, të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë. Komiteti disiplinor kryesohet nga njëri prej zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Tatimeve, që caktohet me urdhër të Ministrit të Financave, dhe ka në përbërje drejtorin/shefin e burimeve njerëzore dhe 3 (tre)



nëpunës të kategorisë A. Komiteti disiplinor i merr vendimet me shumicë votash. Në mbledhjet e këtij komiteti merr pjesë, pa të drejtë vote, në rolin e këshilltarit ligjor, një specialist, jurist, nga drejtoria juridike.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.676, datë 13.8.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E PERSONELIT DHE TË PERSONAVE TË KONTAKTIT PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE JOBUIJQËSORE, SI DHE TË DETYRAVE E PËRGJEGJËSIVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “j” të nenit 2 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e personelit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore, si dhe të detyrave e përgjegjësive të tij.

2. Përgjegjësitë, detyrat dhe kriteret e përzgjedhjes së personelit të regjistrimit janë, përkatësisht:

2.1 Anketuesi

a) Anketuesi ka këto përgjegjësi:

- kontakton dhe interviston ndërmarrjet jobujqësore, të përfshira në regjistrim;  
- i përgjigjet në kohë dhe me cilësi plotësimi të kërkesave të dokumentacionit që i jepet në përdorim;

- është i paanshëm kur plotëson pyetësin, nuk ndikon në përgjigjen e të intervistuarit dhe kontrollon çdo përgjigje për argumentim dhe përputhshmëri;

- respekton rregullat e konfidencialitetit dhe informon të intervistuarin se informacioni i dhënë prej tij është krejtësisht konfidencial dhe publikohet vetëm në mënyrë të përmbledhur e vetëm për qëllime statistikore;

- kontakton stafin e regjistrimit, në Institutin e Statistikave (INSTAT), për çështje të ndryshme lidhur me njësinë që do të anketohet dhe me pyetësin;

- për problemet e ndeshura gjatë intervistimit jep shënime të hollësishme, të shoqëruara edhe me numrin e pyetjes, të “Shënime për anketuesin”.

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë anketuesi ka për detyrë:

- të ketë paraqitje serioze, të sillt në mënyrë korrekte, të jetë i komunikueshëm, këmbëngulës dhe profesional në marrjen e informacionit të kërkuar, gjatë intervistës;

- të intervistojë atë ndërmarrje e cila e ka numrin identifikues të personit të tatueshëm (NIPT) të njëjtë me atë që është shkruar në etiketën e pyetësit;

- të bëjë pyetjet, gjatë intervistimit, ashtu siç janë përcaktuar në pyetësor dhe sipas udhëzimeve të dhëna në manual;

- të përdorë informacionin e marrë vetëm për interesa profesionale e në kuadër të regjistrimit dhe jo për interesa private të vetat a të personave të tjerë;

- t’ia përcjellë informacionin vetëm kontrollorit ose specialistit përgjegjës për regjistrimin;

- të ruajë konfidencialitetin e pyetësit dhe materialeve të regjistrimit;

- të studiojë me kujdes të gjithë përmbajtjen e pyetësorit dhe manualin dhe ta kryejë punën personalisht, sipas udhëzimeve të përfshira në manual, si dhe të gjitha udhëzimeve që jepen nga stafi përgjegjës për kryerjen e regjistrimit;

- të kryejë intervista, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta në ndërmarrje, me përfaqësuesin e saj, presidentin/administratorin, drejtorin ose ekonomistin;

- të prezantojë veten, të tregojë letërnjoftimin dhe autorizimin e INSTAT-it, gjatë kontaktit me përfaqësuesin e ndërmarrjes.

Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e anketuesit nuk mund t'u transferohen personave të tretë.

c) Për t'u përzgjedhur, anketuesi duhet të përmbushë këto kritere:

- të ketë arsimin e mesëm (profili ekonomik përbën përparësi);

- të jetë banor i rrethit ku do të kryhet regjistrimi;

- të jetë i aftë fizikisht dhe i gatshëm për lëvizje në distanca të gjata;

- të shkruajë pastër dhe qartë;

- të ketë aftësi të mira komunikuese.

Përvoja në fushën e vrojtimeve përbën përparësi.

## 2. 2 Kontrollori

### 2.2.1 Kontrollori në qark

a) Kontrollori në qark ka këto përgjegjësi:

- organizon dhe drejton punën e kontrollorëve në rreth dhe merr në dorëzim punën e kryer prej tyre;

- respekton procedurën e regjistrimit për zbatimin e afateve.

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrollori në qark ka për detyrë:

- të organizojë dhe zhvillojë trajnimin e kontrollorëve të rretheve, sipas librit udhëzues, të përgatitur nga INSTAT-i për këtë qëllim, pasi ka kaluar edhe ai vetë trajnimin përkatës;

- të kryejë shpërndarjen dhe grumbullimin e materialeve e dokumenteve të regjistrimit, për kontrollorët e rretheve që mbulon. Kjo veprimtari dokumentohet me procesverbale dhe formularë të përgatitur nga INSTAT-i, për këtë qëllim.

### 2.2.2 Kontrollori në rreth

a) Kontrollori në rreth është përgjegjës për të mbikëqyrur:

- mbarëvajtjen e punës në terren, për mbulimin e anketimit dhe cilësinë e të dhënave të grumbulluara;

- shpërndarjen dhe grumbullimin e të gjitha materialeve dokumentare të regjistrimit, për anketuesit që mbulon, me anë të procesverbaleve të përgatitura nga INSTAT-i, për këtë qëllim.

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, kontrollori në rreth ka për detyrë:

- të organizojë dhe të kryejë trajnimin e anketuesve të ndërmarrjeve, sipas udhëzimeve metodologjike të dhëna, pas trajnimit që ka kaluar edhe ai vetë;

- të organizojë dhe të ndjekë të gjithë punën e anketuesve në terren, sipas detyrave, listave të njësisve dhe afateve të anketimit, të caktuara për çdo anketues (kalendari i punës);

- të kontrollojë cilësinë e të dhënave të pyetësorëve të plotësuar, sipas kritereve metodologjike dhe planit të kontrollit që atij i është dhënë. Kontrollori në rreth bashkëpunon me anketuesit për korrigjimin e gabimeve të vërejtura në plotësimin e pyetësorëve. Ai urdhëron ribërjen e intervistës, kur e gjykon të nevojshme;

- të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesit eprorë, që janë zyra e regjistrimit në qark dhe mbikëqyrësi i qarkut, për probleme të ndryshme;

- të plotësojë formularët përmbledhës dhe raporte të tjera informative lidhur me regjistrimin në rreth;

- të dorëzojë dhe të marrë në dorëzim dokumentacionin përkatës të regjistrimit, kurdoherë të dokumentuar në formularët përkatës, të nënshkruar nga palët;

- të kryejë kontrole në terren.

c) Për t'u përzgjedhur, kontrollori, në qark ose në rreth, duhet të përmbushë këto kritere:

- të ketë arsimin e mesëm (profili ekonomik dhe arsimi i lartë përbën përparësi);

- të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizuese;
- të shkruajë pastër dhe qartë.

Përvoja në fushën e vrojtimeve përbën përparësi.

### 2.3 Mbikëqyrësi në qark

a) Mbikëqyrësi (supervizori) është përgjegjësi kryesor për zbatimin e kriterëve metodologjike, të përcaktuara gjatë regjistrimit të ndërmarrjeve.

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, mbikëqyrësi ka për detyrë:

- të mbajë lidhje të vazhdueshme me kontrollorët në rreth e në qark, të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me zyrën e statistikës në rreth, për probleme të ndryshme gjatë regjistrimit;
- të bëjë sondazhe për të kontrolluar cilësinë e të dhënave të grumbulluara në pyetësorë, duke bërë vërejtje dhe duke urdhëruar korrigjime eventuale;
- të dorëzojë dhe të marrë në dorëzim dokumentacionin përkatës të regjistrimit, të dokumentuar në formularin përkatës, të nënshkruar nga palët.

c) Për t'u përzgjedhur, mbikëqyrësi duhet të përmbushë këto kriterë:

- të ketë arsimin e lartë (profili ekonomik përbën përparësi);
- të ketë njohuri mbi paketën "Microsoft office";
- të jetë i aftë fizikisht për lëvizje në distanca të gjata e për kontrole në terren;
- të njohë territorin administrativ të qarkut që do mbulojë;
- të ketë aftësi të mira organizative;
- të ketë aftësi të mira komunikuese.

Përvoja në fushën e vrojtimeve përbën përparësi.

### 2.4 Personi i kontaktit në organet e qeverisjes vendore;

a) Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10202, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore", kryetari në bashki apo komunë cakton personin e kontaktit, i cili do të asistojë personelin e regjistrimit për të dhënë informacione për identifikimin e njësisë që do regjistrohet, si: adresa, emërtime, objekti i veprimtarisë dhe informacione të tjera ndihmëse.

b) Personi i kontaktit, për t'u përzgjedhur, duhet të plotësojë këto kriterë:

- të jetë punonjës në përbërje të sektorit të taksave vendore apo të biznesit të vogël, në bashkinë ose komunën përkatëse;
- të ketë autoritetin e dhënies së informacionit për evidentimin e subjektit, si: adresa, emërtimi, veprimtaria apo ndonjë informacion tjetër ndihmës;
- të njohë mirë sistemin e adresave të zonës.

3. Përzgjedhja e personelit të regjistrimit do të kryhet nga INSTAT-i, në përputhje me kriteret e miratuara në këtë vendim, si dhe duke respektuar parimet e konkurrencës mes kandidatëve.

3.1 Procedura e përzgjedhjes së personelit të regjistrimit do të kryhet në dy faza:

- faza e parakualifikimit;
- faza e testimit.

Faza e parë përfshin procedurat e hartimit të listës së shkurtuar, duke parakualifikuar kandidatët që plotësojnë kriteret e miratuara në këtë vendim. Faza e dytë, ajo e testimit, përfshin një intervistim të shkurtër të kandidatit para një komisioni të posaçëm *ad-hoc*, të ngritur nga INSTAT-i.

3.2 Ngarkohet INSTAT-i për përgatitjen e materialeve të konkurrimit dhe përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

3.3 Për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes dhe të vlerësimit, INSTAT-i krijon komisione *ad-hoc*, në përbërje të të cilave do të marrin pjesë specialistë të fushës.

4. Ngarkohet INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.677, datë 13.8.2010**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Shtetërore për Projektet e**  
**NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE, ME KONCESION”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121-124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, me koncesion”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.53, datë 19.8.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DISHNICA ENERGJI” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dishnica Energji” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Dishnica Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Dishnica Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec - Dishnice” me fuqi 0.2 MW.
2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.
3. Shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratën e koncensionit.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.54, datë 25.8.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELEKTRO LUBONJA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.8.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Elektro Lubonja” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Elektro Lubonja” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë “Elektro Lubonja” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec - Lubonjë” me fuqi 0.3 MW.
2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.
3. Shoqëria ta fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratën e koncensionit.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.55, datë 25.8.2010**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.8.2010, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “E-Vento S.r.l Albania” sh.p.k,

Dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolike, përveç vonesave administrative në të cilat ka kaluar, ka pësuar edhe dëmtime gjatë këtij viti,

**VENDOSI:**

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr.63, datë 22.9.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.56, datë 25.8.2010**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “HERA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.8.2010, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Hera” sh.p.k,

Dhe duke konsideruar:

Se argumentet e shoqërisë janë të drejta dhe gjithashtu duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë,

**VENDOSI:**

- Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr.65, datë 22.9.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Hera” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta

**KËRKESË**  
**Nr.5285, datë 17.8.2010**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare publike, Lagja e Re, Kukës, ku subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Kukës.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në adresën, Rruga e Durrësit, nr.23, Tiranë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË  
SHKOLLËS 9-VJEÇARE PUBLIKE, LAGJA E RE, KUKËS**

Pronari	Z.K.	Nr.Pas	Sip.truall m <sup>2</sup>	Çmimi truall lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e tokës (lekë)	Vlerë totale shpronësimi (lekë)
Shaban Dan Sopaj	2315	50/28	389.81	2 000	779 620	779 620
Rrahman Kadri Sopaj	2315	50/90	343.15	2 000	686 300	686 300
Ramiz Mehmet Sopaj Kade Ramadan Sopaj Nuri Mehmet Sopaj Ali Mehmet Sopaj Hasiye Mehmet Sopaj Marjeta Mehmet Sopaj	2315	50/57	1457.52	2 000	2 915 040	2 915 040
Xhevdet Hajdin Sopaj	2315 2315	50/40 50/41	726.62 11.50	2 000 2 000	1 476 240	1 476 240
Hakik Kadri Sopaj	2315	50/60	1071.40	2 000	2 142 800	2 142 800

Vlera totale e këtij shpronësimi është 8 000 000 (tetë milionë) lekë.

**VENDIM**  
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1370, datë 14.7.2010, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Leonard Sema, i biri i Llazit dhe i Varvarës, i datëlindjes 6.9.1972 dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij të atin, shtetasin Llazi Sema.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE .....	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË .....	512 lekë

Hyri në shtyp më 17.9.2010  
Doli nga shtypi më 17.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 18 lekë